

Komisionet e aplikuara për pjesëmarrje në ankandin e Obligacioneve të Thesarit

Banka Societe Generale Albania i ofron mundësinë çdo klienti **Individ** të marrë pjesë në Ankandin e Tregut Primar të Obligacioneve të Thesarit.

Komisionet e aplikuara specifikohen si më poshtë vijon:

- Komision ndërmjetësimi - **0.15% i Vlerës Nominale** (Min 1,000 Lekë /10 Monedhë e Huaj - Max 5,000 Lekë / 50 Monedhë e Huaj)
- Komision për shitjen e titullit në një bankë tjetër të nivelit të dytë - **10,000 Lekë / 70 Monedhë e Huaj**
- Komision i pjesëmarrjes (në rast se klienti nuk fiton në ankand) – **1,000 Lekë / 10 Monedhë e Huaj**
- Komision për paisjen e klientit me dokumentin “Dublikatë vërtetim për shpallje fitues” – **500 Lekë / 5 Monedhë e Huaj**

Shembull i përlogaritjes së komisionit të ndërmjetësimit:

Nëse klienti blen në tregun primar një Obligacion Thesari me vlerë nominale 1,500,000 Lekë, komisioni i aplikueshëm në këtë rast është i barabartë me 2,250 Lekë.

$$1,500,000 * 0.15\% = 2,250 \text{ Lekë}$$

Ky komision aplikohet në momentin e investimit.

Komisionet e aplikuara për pjesëmarrje në ankandin e Bonove të Thesarit

Banka Societe Generale Albania ndërmjetëson **vetëm për klientet VIP** pjesëmarrjen në ankandet e zhvilluara nga Banka e Shqipërisë për emetimin e Bonove të Thesarit.

Komisionet e aplikuara specifikohen si më poshtë vijon:

- Komision ndërmjetësimi - **0.5% i Vlerës Nominale**

Komisioni i aplikohet klientit në momentin e investimit.

Shembull i përlogaritjes së komisionit të ndërmjetësimit:

Nëse klienti blen në tregun primar një Bono Thesari me vlerë nominale 1,000,000 Lekë, komisioni i aplikueshëm në këtë rast është i barabartë me 5,000 Lekë.

$$1,000,000 * 0.5\% = 5,000 \text{ Lekë}$$

Ky komision aplikohet në momentin e investimit.